GJYKATA E QARKUT PRISHTINË

KA. Nr. 509/11
6 tetor 2011

Gjyqtari për konfirmim të aktakuzës pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, gjyqtari i EULEX-it, Gianfranco Gallo, në lëndën penale kundër:

Sadik Abazit, emri i babait Hajriz, i lindur me 9 Nëntor 1959 në fshatin Davidovc, Komuna e Shtimes, aktualisht me adresë të panjohur, mashkull, shqiptar nga Kosova, Shtetas i Kosovës, IN K00260409;

Driton Hajdarit, emri i babait i panjohur, i lindur me 12 Qershor 1980 në Prishtinë, aktualisht banues në Rrugën Vëllezërit Fazliu, 26, Vranjevc, Prishtinë, mashkull, shqiptar nga Kosova, shtetas i Kosovës, IN 1019788446;

Shaban Sylës, emri i babait Rizah, i lindur me 10 Dhjetor 1965 në Kishnarekë, komuna e Gllogovcit, aktualisht banues në Gllogovc, mashkull, shqiptar nga Kosova, shtetas i Kosovës, IN i panjohur;

Shpresim Ukës, emri i babait i panjohur, i lindur me 8 Janar 1968 në Beograd, Serbi, aktualisht banues në Ismet Krasniqi 100, Prishtinë, mashkull, shqiptar nga Kosova, shtetas i Kosovës, IN K00100973

Bekim Sylës, ,emri i babait i panjohur, i lindur me 18 Prill 1976 në Kishnarekë, komuna e Gllogovcit, aktualisht banues në Gllogovc, mashkull, shqiptar nga Kosova, shtetas i Kosovës, IN i panjohur;

Fahredin Gashit, emri i babait Hajredin, i lindur më 8 dhjetor 1969 në Shtime, me banim në rr. Halime Arana 6/33, Prishtinë, shqiptar nga Kosova, aktualisht në paraburgim në një rast tjetër;

Të gjithë të ngarkuar nga Prokuroria e PSRK-së për kryerjen e veprave penale si më poshtë:

Akuza 1

Sadik Abazi, Bekim Syla, Fahredin Gashi *dhe* ***Shpresim Uka*** *në bashkë-kryerje me Nazim Bllacën (të deklaruar dëshmitar bashkëpunues nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 4 mars 2011) kanë kryer veprën penale* ***Vrasje e rëndë****, e parashikuar dhe e dënueshme sipas nenit 30 (1) dhe (2) të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste të Kosovës, në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, aktualisht penalizuar sipas neneve 146 dhe 147, pikës 3, dhe nenit 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), për shkak se të pandehurit e lartpërmendur kanë vrarë* ***Ibush Kllokoqin*** *duke e lënë të vdekur me disa të shtëna me armë zjarri. Në mënyrë specifike, në natën e vrasjes, Fahredin Gashi i*

ka siguruar Nazim Bllacës një lloj të armës Scorpion. Pastaj të njëjtën natë ata së bashku me Shpresim Ukën, Bekim Sylën dhe Sadik Abazin kanë shkuar tek shtëpia e viktimës. Shpresim Uka ka pritur afër shtëpisë derisa Nazim Bllaca, Sadik Abazi, Fahredhin Gashi dhe Bekim Syla kanë trokitur në derën e shtëpisë së Kllokoqit. Kur viktima u shfaq në derë, Nazim Bllaca e vrau atë me së paku 6 plumba, qëlluar nga arma e përmendur më lart.
- Në Prishtinë, më 6 gusht 1999

Akuza 2

Sadik Abazi, Fahredin Gashi, Shpresim Uka, Driton Hajdari dhe Bekim Syla *në bashkë-kryerje me Nazim Bllacën (të deklaruar dëshmitar bashkëpunues nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 4 mars 2011) kanë kryer veprën penale* ***Vrasje e rëndë në tentativë****, e parashikuar dhe e dënueshme sipas nenit 30 (1) dhe (2) të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, dhe nenet 19 dhe 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, aktualisht penalizuar sipas neneve 146 dhe 147, pikës 3, së bashku me nenet 20 dhe 23 të KPK-së, për shkak se të pandehurit e lartpërmendur kanë tentuar të privojnë nga jeta* ***Ismet Arifin*** *duke shtënë në të disa herë. Më saktësisht, ata kanë shkuar në ndërtesën ku ka jetuar Ismet Arifi me gruan dhe djalin e tij. Fahredin Gashi e ruante derën e hyrjes së ndërtesës. Nazim Bllaca dhe Shpresim Uka po ruanin katin e tretë, përderisa Sadik Abazi, Driton Hajdari dhe Bekim Syla kanë shkuar në apartamentin e Ismet Arifi dhe kanë trokitur në derë. Pasi që kanë kërkuar nga gruaja e Arifit, e cila kishte hapur derën, që të flisnin me burrin e saj ata kanë tentuar që ta bëjnë Ismet Arifi, që të largohet nga apartamenti dhe të i ndiqte ata. Pas refuzimit të tij, viktima është kapur menjëherë pas qafe dhe është qëlluar në shputën e tij të djathtë, të zbathur. Sapo Ismet Arifi ia ka dalur të vrapojë lart shkallëve për në katin e sipërm janë qëlluar disa të shtëna drejt tij, por plumbat thjesht rastësisht nuk e kanë qëlluar viktimën.*
- Në Prishtinë më 3 nëntor 1999

Akuza 3

Shpresim Uka, Driton Hajdari dhe Shaban Syla *në bashkë-kryerje me Nazim Bllacën (të deklaruar dëshmitar bashkëpunues nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 4 mars 2011) kanë kryer veprën penale* ***Vrasje e rëndë në tentativë****, e parashikuar dhe e dënueshme sipas nenit 30 (1) dhe (2) të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe nenet 19 dhe 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, aktualisht penalizuar sipas neneve 146 dhe 147, pikës 3 së bashku me nenet 20 dhe 23 të KPK-së për arsye se të pandehurit e lartpërmendur kanë tentuar të privojnë nga jeta* ***Adem Salihajn*** *duke ngritur një pritë në mënyrë që ta vrisnin me të shtëna armësh zjarri. Në ditën e vrasjes në tentativë, Driton Hajdari ka drejtuar një makinë Opel Omega, duke ndjekur makinën e Adem Salihajt. Shaban Syla ishte ulur në ulësen e përparme të makinës Omega, i armatosur me një pistoletë, dhe një person i tretë, një mashkull i paidentifikuar deri më tani, ishte ulur në ulësen e pasme. Nazim Bllaca dhe Shpresim Uka ishin duke drejtuar një BMW të zezë para veturës së Salihajt, për t'a ngadalësuar atë. Kur ka ardhur momenti i duhur, vetura Omega e ka rrethuar veturën e Salihajt, dhe Shaban Syla i ka drejtuar pistoletën e tij viktimës. Adem Salihaj ka reaguar menjëherë duke ia drejtuar pistoletën e tij Shaban Sylës, i cili nuk ka qëlluar asnjë të shtënë për arsye se i është bllokuar pistoleta*

dhe/ose për shkak të reagimit të papritur të viktimës.

- ***Në Ferizaj më 12 qershor 2000.***

Pas mbajtjes së seancës së konfirmimit të aktakuzës më 15 dhe 22 shtator 2011, në praninë e të pandehurve, avokatëve të tyre mbrojtës, dhe Prokurorit Publik;

Në pajtim me nenin 316, paragrafin 1, pikën 4, në këtë mënyrë lëshon si në vijim:

AKTVENDIM

Aktakuza PPS 460/09, ngritur më 29 korrik 2011, siç është ndryshuar gjatë seancës së konfirmimit të aktakuzës, të mbajtur më 15 shtator 2011, në këtë mënyrë konfirmohet në tërësi.

Aktakuza së bashku me të dhënat e dosjes së lëndës, do të i dërgohen kryetarit të trupit gjykues të shqyrtimit gjyqësor, menjëherë pasi aktvendimi të merr formën e prerë.

ARSYETIM

Historiku procedural.

Më 29 korrik 2011 Prokurori i PSRK-së, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve të lartpërmendur, duke i ngarkuar ata me veprat penale të përshkruara më lart.

Seancat publike të konfirmimit të aktakuzës janë mbajtur më 15 dhe 22 shtator 2011.

Prokurori ka lexuar aktakuzën, në pajtim me nenin 314 (3) të KPPK-së.

Duke i pyetur të pandehurit nëse e kanë kuptuar aktakuzën, gjyqtari u ka dhënë mundësinë për të pranuar apo mos pranuar fajësinë, siç është paraqitur në nenin 314 (4) të KPPK-së. Të gjithë të pandehurit kanë dëshmuar se ata e kanë kuptuar aktakuzën dhe nuk e kanë pranuar fajësinë.
Gjyqtari atëherë i dha fjalën palëve për deklaratat e tyre, ashtu siç parashihet me nenin 314 (5) të KPPK-së.

Deklaratat e palëve.

Prokurori, pasi që ka ndryshuar aktakuzën duke theksuar se ngjarjet e përshkruara në akuzën 3 të aktakuzës, në fakt kanë ndodhur më 12 qershor 2000, ai kërkoi konfirmimin e aktakuzës.

Të gjithë avokatët mbrojtës kanë kërkuar që aktakuza të hudhet poshtë.

Mbrojtja ka theksuar se disa nga deklaratat e dhëna nga dëshmitari bashkëpunues Nazim Bllaca (që do të thotë deklaratat e dhëna më 30 nëntor 2009, 3 dhjetor 2009 dhe 1 nëntor 2010) janë të papranueshme, për arsye se në atë kohë Bllaca ishte i pandehur dhe vetëm më pas ai është deklaruar dëshmitar bashkëpunues.
Më konkretisht mbrojtja ka kërkuar që të përjashtohen deklaratat e mësipërme, në bazë të argumentit se obligimet e të pandehurit janë të ndryshme nga ato të dëshmitarit (në veçanti në lidhje me detyrimin për të thënë të vërtetën) dhe prandaj do të ishte e paligjshme të përdoreshin deklaratat e dhëna nga Bllaca në cilësinë e tij si i pandehur, pasi që ai aktualisht është dëshmitar bashkëpunues.

Për më tepër, mbrojtja pretendon se provat e bazuara në bisedën e incizuar nga Bllacea duhet të përjashtohen, pasi që bisedat e sipër cekura janë përgjuar pa një urdhër të Autoritetit Gjyqësor.

Mbrojtja gjithashtu ka paraqitur ankesë ndaj urdhërit të gjyqtarit të procedurës paraprake ku me anë të të cilit Bllaca deklarohet dëshmitar bashkëpunues, duke pretenduar se urdhëri është lëshuar në shkelje të nenit 300, par. 5 të KPPK, pasi që Bllaca ishte organizuesi apo udhëheqësi i grupit i cili ka kryer veprat penale.

Përfundimisht, të gjithë avokatët mbrojtës kanë theksuar paqartësinë, mungesën e saktësisë dhe kundërshtimet e brendshme të të gjitha akuzave të aktakuzës.

Sa i përket meritës së rastit, avokatët mbrojtës kanë nënvizuar pabesueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues, duke vënë në dukje mospërputhjet e shumta të brendshme dhe të jashtme të tregimit të dhënë nga Bllaca.

Të gjetura e gjyqtarit të konfirmimit:

Kundërshtimet procedurale të ngritura nga palët janë të pavlefshme.

Sa i përket pyetjes së ngritur në lidhje me pranueshmërinë e deklaratave të dhëna nga Nazim Bllaca, duhet theksuar se, në pajtim me nenin 153 të KPPK-së, provat e marra në shkelje të dispozitës së procedurës penale duhet të jenë të papranueshme, vetëm kur ligji qartë parashikon ashtu.

Megjithatë, deklaratat e mësipërme madje as nuk përbëjnë prova të marra në kundërshtim me ligjin, pasi që gjatë kohës së ekzaminimeve të mësipërme Nazim Bllaca ishte i pandehur dhe prandaj ka mundur të ekzaminohej vetëm në atë cilësi.
Provat janë marrë në pajtim me ligjin dhe në fakt nuk ka kurrfarë dispozite e cila vendos për përjashtimin e deklaratave të dhëna nga i pandehuri, i cili më pastaj është deklaruar dëshmitar bashkëpunues.

Prandaj, provat e mësipërme janë të pranueshme dhe do të mbesin në dosje të lëndës.

Sa i përket kundërshtimin në lidhje me bisedën e incizuar nga Bllaca, duhet të theksohet se një veprim i tillë incizimi nuk mund të kualifikohet si masë e fshehtë, në pajtim me dispozitat e parashikuara me nenin 256 dhe të atyre në vijim të KPPK-së.

Në fakt, koncepti i përgjimit përfshin një aktivitet të kapjes së bisedave, i cili është i fshehtë për të gjitha palët e pranishme apo të atyre që janë duke zhvilluar bisedën; kjo kapje e fshehtë e bënë këtë aktivitet "të fshehtë" dhe përfundimisht kërkon një urdhër të Autoritetit Gjyqësor. Ndërsa, kur biseda incizohet vullnetarisht nga njëri prej personave të pranishëm në bisedë (siç ka ndodhur në rastin aktual), nuk ka nevojë për ndonjë urdhër nga Autoriteti Gjyqësor dhe mbështetja në të cilën është incizuar biseda është vetëm një pjesë e provave materiale plotësisht e pranueshme dhe, nëse paraqitet në shqyrtim gjyqësor, në pajtim me dispozitat e neneve 367 dhe 371 të KPPK-së.

Nga deklaratat e dhëna nga Nazim Bllaca, nuk del se ai ka qenë organizuesi apo udhëheqësi i grupit të njerëzve që kanë kryer krimin, dhe prandaj gjyqtari i procedurës paraprake nuk e ka shkelur dispozitën e parashikuar në nenin 300, par. 5 të KPPK-së.

Gjithashtu, kundërshtimi në lidhje me paqartësinë dhe kontradiktat e akuzave është i pabazuar. Akuzat përshkruajnë qartë sjelljet e ndërmarra nga të gjithë të pandehurit dhe rolet e tyre në kryerjen e veprimtarive kriminale, duke specifikuar kohën dhe vendin e kryerjes së krimit dhe prandaj duke përmbushur kërkesat e nenit 305, par. 1, pikës 4 të KPPK-së.

Sa i përket meritave të rastit, duke patur parasysh se aktvendimi mbi konfirmimin e aktakuzës nuk duhet të paragjykojë gjykimin e çështjeve, që do të konsiderohen në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtari për konfirmim të aktakuzës vëren se provat në dosje të rastit janë të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprat penale me të cilat ngarkohen.

Është e padiskutueshme se pjesa kryesore e provave është dhënë nga deklaratat që z. Nazim Bllaca u ka dhënë hetuesve.

Z. Bllaca ka dhënë një përshkrim shumë të detajuar mbi atë se si kanë ndodhur ngjarjet dhe një tregues të saktë të rolit të secilit të pandehur në lidhje me secilën nga tri veprat penale, gjithashtu duke specifikuar rrethanat faktike dhe arsyet për kryerjen e krimeve.

Tregimi i dëshmitarit bashkëpunues shfaqet të jetë koherent në thelb dhe ka marrë mbështetje të fortë nga jashtë nga dëshmitë e dëshmitarëve okular dhe palëve të dëmtuara, të cilët ishin të pranishëm në vendin e krimit, kur janë kryer vrasja dhe dy vrasjet në tentativë.

Për më tepër, versioni i ngjarjeve i dhënë nga Bllaca vërtetohet nga disa prova materiale: raporti i ekspertizës së datës 27 gusht 2010 nga gëzhojat e marra në vendin e vrasjes së Ibush Kllokoqit dhe në lidhje me vrasjen në tentativë të Ismet Arifit, raporti i hospitalizimit të z. Driton Hajdari dhe biseda e incizuar nga Bllaca.

Gjyqtari për konfirmim të aktakuzës pranon se ka disa mospërputhje të brendshme dhe të jashtme sa i përket versionit të ngjarjeve, të dhënë nga dëshmitari bashkëpunues, por duke patur parasysh kohën që ka kaluar (ngjarjet kanë ndodhur gati dhjetë vjet para ekzaminimit të parë të Bllacës), kjo nuk mund ta dobësojë besueshmërinë e përgjithshme të treguar nga dëshmitari bashkëpunues.

Për arsyet e mësipërme, gjyqtari për konfirmim të aktakuzës ka marrë në konsideratë se Prokuroria kanë mbledhur prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale të sipër cekura.
Pasi që, nuk ekziston asnjë nga rrethanat nën nenin 316, par. 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, prandaj aktakuza konfirmohet në tërësi.

Për të gjitha këto arsye është vendosur sikur se në dispozitiv.

Gjyqtari për konfirmim të aktakuzës
Gianfranco Gallo

Këshillë ligjore:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë